



Vështrim i përgjithshëm i "Child Health Plus"

KUSH KUALIFIKOHET?

FËMIJËT QË:

- Janë nën 19 vjeç
- Janë banorë të shtetit të Nju-Jorkut
- Nuk kualifikohen për "Medicaid"
- Nuk mbulohen nga sigurime të tjera shëndetësore
- Nuk kualifikohen apo që nuk janë të regjistruar në mbulimin shëndetësor nëpërmjet ndonjë programi shtetëror të përfitimit shëndetësor (NYSHIP)
- Kualifikohen pavarësisht statusit të emigracionit

"NY State of Health" pajtohet me ligjet e zbatueshme federale për të drejtat civile dhe nuk diskriminon në bazë të racës, ngjyrës, kombësisë, gjinisë, moshës apo aftësisë së kufizuar në programet dhe veprimtaritë e saj shëndetësore.

ÇFARË MBULOHE?

- Vizita normale për fëmijë
- Ekzaminime fizike
- Vaksinime
- Shërbime laboratorike dhe imazherie
- Shërbime emergjence
- Barna me recetë
- Barna pa recetë, nëse porositen nga mjeku
- Shtrim në spital
- Shërbime afatshkurtra terapeutike për pacientët e jashtëm (kimioterapi, hemodializë)
- Shërbime të shëndetit mendor dhe të çrregullimeve nga abuzimi me substancat për pacientë të shtruar dhe të jashtëm
- Shërbime dentare dhe okulistike
- Shërbime për të folurin dhe të dëgjuar
- Pajisje mjekësore për përdorim afatgjatë
- Shërbim kujdesi paliativ pediatrik

NA KONTAKTONI:

nystateofhealth.ny.gov | 1-855-355-5777 ose TTY 1-800-662-1220

SA KUSHTON NJË PLAN I "CHILD HEALTH PLUS"?

PRIMET MUJORE: Çmimi mujor varet nga të ardhurat familjare dhe nga madhësia e familjes.* Nuk ka prim mujor për familje me të ardhura të ulëta. Familjet me të ardhura të larta paguajnë një prim mujor, në përputhje me grafikun e mëposhtëm. Për familje më të mëdha, tarifa mujore kufizohet në deri tre fëmijë. Familjet me të ardhura mbi nivelin për mbulim të subvencionuar mund të paguajnë primin e plotë që luhatet sipas pjesëmarrjes në planin shëndetësor.

NDARJA E KOSTOVE: "Child Health Plus" nuk ka zbritje vjetore apo forma bashkëpagimi.

Të ardhurat maksimale vjetore sipas madhësisë së familjes				Kontributi mujor familjar për fëmijë (nr. maksimal i fëmijëve për të cilët paguani është deri në 3)
1	2	3	4	
më pak se \$19,424	më pak se \$26,336	më pak se \$33,248	më pak se \$40,160	\$0
\$26,951	\$36,542	\$46,132	\$55,722	\$9 (maks. \$27)
\$30,350	\$41,150	\$51,950	\$62,750	\$15 (maks. \$45)
\$36,420	\$49,380	\$62,340	\$75,300	\$30 (maks. \$90)
\$42,490	\$57,610	\$72,730	\$87,850	\$45 (maks. \$135)
\$48,560	\$65,840	\$83,120	\$100,400	\$60 (maks. \$180)
mbi \$48,560	mbi \$65,840	mbi \$83,120	mbi \$100,400	Prim i plotë, luhatet sipas planit shëndetësor

*Bazuar në Nivelet Federale të Varfërisë (FPL) të vitit 2018. Nivelet e të ardhurave mund të përshtaten çdo vit, bazuar në ndryshimet e FPL-së.